

Virusi-Hepatitis-B

Bëhet fjala për një sëmundje infektive që njihet prej vitesh dhe shkaktohet nga virusi Hepatitis-B. Sëmundja shkaktonë një infeksion të mëlçisë dhe futet në sëmundjet që duhet të lajmërohen. Mundet të shfaqen simptomat e më poshtëme të sëmundjes:

Dhimbje të pjesës së sipërme të barkut që janë të një llojit të veçantë, mungesa e oreksit, marrje mendsh, të vjella, lodhje dhe ngjyrë e verdhë e lëkurës.

Ndërsa infeksioni me Hepatitis-A të shumtën e rasteve shërohet pa pasoja, në rast të një infeksioni akut me Hepatitis B mundet të shkaktohet një përhapje e virusit në trup dhe të shkaktohet një infeksion kronik i mëlçisë. Mendohet se në rreth 10-15% të rasteve ndodh një gjë e tillë. Personat e infektuar janë të rrezikuar si rezultat i një shkatërimi në frittje të qelizave të mëlçisë, si rezultat i humbjes së strukturës së mëlçisë (ceroza e mëlçisë) ose shfaqjes së kancerit të mëlçisë.

Përhapja e virusit të Hepatitis-B bëhet nëpërmjet gjakut dhe lëngjeve trupore, në të cilat përmbahet ky virus.

- Në kohë e më parshme është vënë re infeksioni me Hepatitis B pas transfuzioneve të gjakut. Tashmë, si rezultat i kontrolleve të sakta që kryhen, kjo rrugë infeksioni nuk luan më asnjë rol.
- Rruga më e përhapur e infeksionit është ajo e marrëdhënies seksuale, sidomos si rezultat i marrëdhënies seksuale pa u mbrojtur me përdorimin e kondomit me partnerë, e kaluara e të cilëve nuk njihet, që përdorin drogën dhe që i ndrojnë shpesh partnerët e tyre.
- Te personat që përdorin drogën dhe që përdorin shiringat e njëri tjetrit, shpesh shkaktohet përhapja e virusit të Hepatitis-B.
- Të rrezikuar janë edhe personat që kanë në profesionin e tyre shpesh kontakte me gjakun dhe me produktet e gjakut, si psh. personeli mjeksor, pasi virusi mundet të përhapet edhe si rezulta i kontaktit gjak me gjak.
- Rrugë tjetër infeksioni është tetovimi, akupunktura si dhe shpuarja e veshëve.
- Infektimi i fëmijës nga një nënë e infektuar është e mundur vetëm gjat procesit të lindjes.

Mbrojtja nga infektimi me virusin e Hepatitis-B është e mundur. Një mundësi që duhet të përmendet është vaksinimi, i cili është në mënyrë të veçantë për tu rekomanduar te personat që janë të rrezikua nga ky infeksion dhe që ndërkohë po kryhet te shumica e fëmijëve. Përdorimi i kondomave (perzevativëve) mundet të mënjanojë infeksionin me virus të Hepatitis-B, një lloj si me virusin HIV (SIDA). Personat që përdorin drogën, nuk duhet të përdorin shiringat e përdorura nga të tjerët. Personeli mjeksor duhet të zbatojë rregulloren e caktuar gjat punës me gjakun dhe produktet e tij.

Të gjithë të infektuarit me virusin Hepatitis B duhet të zbatojnë rregullat e më poshtëme:

- Duhet të informohen të gjithë partnerët, me të cilët keni kontakt seksual, për Hepatitis B.
- Duhet të përdoren kondome. Partnerët seksual që nuk janë të infektuar duhet të kontrollohen dhe të vaksinohen.
- Mjekët, mjekët e dhëmbëve, ndihmësja në lindje, praktikantët shëruar si dhe personeli i ndihmës së shpejtë, duhet të informohen për infeksionin tuaj me Hepatitis B.
- Nuk lejohet të dhurohni gjak. E njëjta gjë vlenë për dhurimin e spermës, të organeve apo të indeve tuaja trupore.
- Shiringat e injektimit, pas përdorimit, nuk lejohet të përdoren nga persona të tjerë (personat që marrin drogë)
- Ju bëhet e ditur, se infektimi i personave të tjerë nga ana juaj, për fajin tuaj, dënohet sipas ligjit si plagosje trupore.

Në rastë se keni pyetje të tjera, apo dëshironi një bisedë informative të fshehtë, mundeni të na thërrisni në numrin: